



## FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT

ALBANIAN FOOTBALL ASSOCIATION

### DEKLARIMI I POLITIKAVE TË LICENSIMIT TË KLUBEVE TË FSHF-SË

Për Federatën Shqiptare të Futbollit zbatimi i sistemit të licensimit të klubeve është dhe mbetet një nga prioritetet kryesore të punës së saj.

Është objektivi ynë që të sigurojmë që ky sistem funksionon siç duhet dhe që i gjithë informacioni që klubet duan, për t'u pajisur me licensë është i disponueshëm për ta.

Parimet bazë të sistemit janë pavarësia dhe konfidencialiteti, kjo veçanërisht gjatë procesit të vendimmarrjes.

FSHF angazhohet të vërë në zbatim sistemin e licensimit të klubeve sipas Rregulloreve të përcaktuara.

Kryesore mbetet që klubet të kuptojnë që zbatimi i tyre nuk ka rëndësi vetëm për të siguruar licensën por më së shumti do të ndikojë në mirëfunksionimin e vetë klubit.

Për përmirësimin e vazhdueshëm të nivelit të shërbimeve ndaj tyre, si dhe për të rritur efektivitetin e sistemit të licensimit, ne do të kërkojmë që klubet dhe partnerët e jashtëm të jenë sa më pranë që të jetë e mundur dhe të përfshihen në rishikimin vjetor të këtij procesi.

FSHF do të zbatojë një sistem menaxhimi cilësor për licensimin e klubeve dhe do të sigurojë dhe respektojë kërkesat e përcaktuara nga Standarti i Cilësisë së Licensimit të Klubeve.

FSHF siguron që të gjithë njerëzit e përfshirë në sistemin e licensimit të klubeve janë të trajnuar siç duhet dhe plotësisht të ndërgjegjshëm për detyrat e tyre. Gjithashtu, të gjithë ata që janë të përfshirë në këtë sistem duhet të veprojnë në mënyrë etike dhe të respektojnë vlerat në bazë të konfidencialitetit dhe pavarësisë.

FSHF do të kërkojë vazhdimisht që përmes procedurave të arrijë:

- \* Plotësimin e minimumit të kërkesave të parashtruara në Rregulloren e Licensimit të Klubeve.
- \* Garantimin dhe ruajtjen e sekretit të klubit aplikant.
- \* Garantimin e paanshmërisë së organeve vendimmarrëse dhe stafit.
- \* Garantimin e marrjes së veprimeve parandaluese për shmangien e problemeve.
- \* Garantimin e trajtimit me efikasitet të opinioneve, sugjerimeve dhe ankesave të klubeve.



## FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT

ALBANIAN FOOTBALL ASSOCIATION

Duhet të sigurojmë më tej që të gjithë ata që janë përfshirë në sistem të marrin informacionet e nevojshme, dhe të trajnohen dhe ndërgjegjësohen për detyrat e tyre.

Bashkëpunimi, ndihmesa si dhe marrja në konsideratë e ankesave dhe sugjerimeve të klubeve do të mbetet një nga detyrat tona më të rëndësishme.

Do të punojmë për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit duke përdorur metoda dhe shembuj nga homologët tanë në federatat e tjera Europiane.

Si pjesë e misionit tonë thelbësor për promovimin, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e lojës, politika riafirmim dhe forcon angazhimin e FSHF-se & UEFA-s për të siguruar që futboli është një përvojë e sigurt, pozitive dhe e këndshme për të gjithë fëmijët e përfshirë në lojë, pavarësisht nga mosha, gjinia, orientimi seksual, etninë, prejardhjen sociale, fenë dhe nivelin e aftësisë ose aftësisë së kufizuar.

Organizimi ligjor i klubeve të futbollit, përmirësimi i komunikimit me klubet dhe kualifikimi i stafit të tyre do të mbetet prioriteti ynë kryesor.

Gjithashtu FSHF do të fokusohet në përmirësimin e Infrastrukturës dhe arritjen e standarteve bazë të saj.

Ky objektivi bëhet i realizueshëm nëse do t'i referohemi dhe projekteve të Federatës lidhur me përmirësimin e terreneve të lojës në shumë stadione të vendit.

Do të kërkojmë nga klubet të ndermarin politika për mbështetjen shëndetësore, përgjegjësinë sociale, përmirësimin dhe mbrojtjen e mjedisit, për të gjithë fëmijët e akademive si dhe për të gjithë lojtaret e rritur (femra dhe meshkuj).

Per Federaten Shqiptare te Futbollit.

ILIR SHULKU

Sekretar i Përgjithshëm

03 Nentor 2025



**Adresa:** Shtëpia e Futbollit,  
**Rruga:** "Liman Kaba", Nr 5  
**Kodi Postar:** 1019, Tirane, Albania

**Tel:** + 355 4 23 46 601  
**Fax:** + 355 4 23 46 609

**Web:** [www.fshf.org](http://www.fshf.org)  
**Email:** [info@fshf.al](mailto:info@fshf.al)